



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KUVENDI**  
**Komisioni i Ligjeve**

**R E L A C I O N**

**Per dekretin nr. 2363, dt. 10.05.1999 te Presidentit**  
**“Per kthimin e ligjit nr. 8480, dt. 29.04.1999**  
**“Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore**  
**dhe enteve publike”**

Komisioni i Ligjeve, ne mbledhjen e dates 24.05.1999, mori ne shqyrtim dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike”.

Komisioni u njoh me arsyet e kthimit te ligjit nga Presidenti nepermjet Keshilltarit te tij juridik.

Komisioni diskutoi rreth ketyre arsyeve dhe pasi degjoi edhe specialistin qe ka mbrojtur kete ligj ne komision dhe séance plenare arriti ne perfundimin qe ligjit ne fjale duhet t’i behen sakesimet per te cilat Presidenti e ka kthyer ligjin.

1. Persa i perket shqetesimit te ngritur ne piken e pare, qartesimi i konceptit te entit publik, megjithe rezervat, jemi te mendimit se kjo gje i takon doktrines dhe jo ketij ligji.  
Prandaj propozojme qe ne nenin 1 te ketij ligji te shtohet nje paragraf i dyte me kete formulim:

*“Me ent publik per qellimet e ketij ligji do te kuptohet cdo subjekt i se drejtes publike jo shteterore, i krijuar me ligj dhe qe synon realizimin e nje interesi publik”.*

- Titulli i nenit nga “perkufizim” te behet “perkufizime”

2. Per piken e dyte, ne nje perpjekje per te sqaruar se çfare do te ndodhe me ato organe ekzistuese te administrates shteterore dhe te enteve publike, te cilat e zhvillojne veprimtarine e tyre ne perputhje me ligjet ekzistuese, propozojme te shtohet nje nen tjetër pas nenit 17 me kete permbajtje:


S.P.  
22/5/99

“Te gjitha ato organe kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike te cilat funksionojne mbi bazen e ligjeve te posaçme do te vazhdojne te funksionojne mbi bazen e ligjeve ekzistuese per sa kohe qe keto te fundit do te jene ne fuqi.

Veprimtaria ~~te~~ organeve kolegjiale ekzistuese do t’i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji vetem per ato çeshtje (aspekte) te cilat jane te parregulluara nga ligjet e posaçme”.

**Zamira ÇAKA**

**KRYETARE**



S.P.  
27/5/15